



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**

AUTOREFERAT

**ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË DUKURIVE
PËRKTHIMORE DHE GJINORE NË PËRKTHIMET NGA GJUHA
ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE**

(PUNIM PËR GRADËN DOKTOR I SHKENCAVE)

Përgatiti:
M.Sc. NEJLA QAFMOLLA

Udhëheqës shkencor:
Prof. Dr. VIKTOR RISTANI

Tiranë, 2017

FALENDERIME

Do të doja të shprehja mirënjohjen time të thellë për të gjithë ata që më ndihmuan në këtë rrugëtim të gjatë për kurorëzimin e punës sime.

Fillimisht do të dëshiroja të falënderoja dhe të shprehja mirënjohje të sinqertë për udhëheqësin shkencor Prof. Dr. Viktor RISTANI, për ndihmën dhe mbështetjen e dhënë gjatë përgatitjes së këtij punimi nëpërmjet sugjerimeve dhe vërejtjeve konstruktive e të vlefshme.

Gjithashtu dëshiroj të falënderoj ish-pedagogët, sot kolegët e miqtë e mi në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe në Departamentin e Gjuhës Angleze për dashamirësinë, ndihmën dhe këshillat që më kanë dhënë gjatë kësaj periudhe dhe për mirëkuptimin që kanë treguar. Periudha e studimit pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja ka qenë vërtetë frytdhënëse dhe në një mënyrë apo në një tjetër ka ndikuar në këtë punim.

Këtë punim ia dedikoj prindërve Katerina dhe Enver, motrës sime Bujana dhe Ilvit, të cilët më kanë qëndruar gjithmonë pranë me mbështetjen dhe inkurajimin e tyre të vazhdueshëm për të ecur përpara.

TABELA E PËRMBAJTJES

<i>Shkurtime</i>	<i>i</i>
<i>Hyrje</i>	<i>ii</i>
<i>I. Dukuri gjinore të strukturimit të veprave letrare me në qendër figurën e femrës</i>	1
1.1 Modelet gjuhësore të teksteve	8
1.1.1 Modelet gjuhësore implicite dhe eksplicite	8
1.1.2 Modelet krahasimore tradicionale të tekstit	9
1.2. Modelet feministe të teksteve	13
1.2.1 Strukturimi i fjalive në veprat letrare në këndvështrimin gjinor	21
1.2.2 Letërsia feministe nën ndikimin e faktorëve ndërkulturorë dhe ideologjikë	23
1.2.3 Këndvështrimi gjinor dhe interpretimi i tekstit. Seksizmi në gjuhë	27
<i>II. Analiza e tekstit dhe funksionimi i tij brenda sistemit. Kritika feministe</i>	36
2.1 Analiza stilistike në nivelin e fjalës	39
2.1.1. Përemrat e pacaktuar	39
2.1.2 Emrat e përgjithshëm	41
2.1.3 Femërorja si formë “e shënuar”	42
2.1.4 Gjuha pa gjini	43
2.1.5 Seksizmi dhe androcentrizmi	44
2.1.5.1 Cënimi semantik i femrës	46
2.1.5.3 Fjalorët	49
2.2 Analiza stilistike në nivelin e frazës/fjalisë	53
2.2.1 Shprehjet e gatshme	53
2.2.2 Supozimet dhe nxjerrja e konkluzioneve	55
2.2.3 Metafora	55
2.2.4 Modelet e foljeve kalimtare dhe jokalimtare	56
2.3 Analiza stilistike në nivelin e ligjërit	58
2.3.1 Personazhet dhe rolet e tyre	59
2.3.2 Fragmentimi	63
2.3.3 Fokalizimi	65

III. Vështrim panoramik mbi sfondin historik dhe letrar të veprës së Tomas Hardit	69
3.1 Tomas Hardi dhe Epoka Viktoriane	69
3.1.1 Vështrim i përgjithshëm i Epokës Viktoriane	69
3.1.2 Letërsia gjatë Epokës Viktoriane	72
3.1.2.1 Imazhi piktoresk në poezi	75
3.1.3 Çështja e gruas	76
3.1.4 Jetëshkrimi i shkrimtarit viktorian në kuadrin e Epokës Viktoriane	77
3.1.5 Veprat e botuara	79
3.2 Elementë karakterizues të krijimtarisë së Tomas Hardit. Tiparet e prozës së tij	80
3.2.1 Trajtimi i problemeve të kohës	84
3.3 “Tesi i d’Erbervilëve”	86
3.3.1 Sfondi historik i romanit	86
3.3.2 Jeta e Tesit. Gruaja dhe shoqëria	87
3.4 Aktet ligjërimore tek “Tesi i d’Erbervilëve”	98
3.5 Analiza rrëfimtare si akt ligjërimor	101
IV. Simbolika, imazhet dhe aspekte të strukturimit e interpretimit të veprës së Tomas Hardit “Tesi i d’Erbervilëve”	108
4.1 Simbolika dhe imazhet	108
4.1.1 Simbolet dhe imazhet e huazuara nga natyra	108
4.1.2 Simbolet dhe imazhet e kafshëve	114
4.1.3 Simbolet dhe imazhet e shpendëve	114
4.1.4 Imazhi i gjakut	117
4.1.5 Funkzioni simbolik i peizazhit	117
4.1.6 Simbole të tjera	126
4.2 Natyra dhe ndikimi i pranisë së Hardit tek “Tesi i d’Erbervilëve”	128
4.2.1 Hardi si dëshmitar i padrejtësisë dhe epërsisë së mashkullit	129
4.2.2 Funkzioni i pranisë së Hardit në roman	134
4.2.3 Toni i përdorur gjatë rrëfimit	138
4.2.4 Prania e autorit gjatë ndërprerjeve të historisë	140
4.2.5 “Fati” dhe “Natyra”	142
4.3. Dykuptimësia dhe interpretimi në rrëfimin e Hardit tek “Tesi i d’Erbervilëve”	143

V. Vështrim panoramik mbi sfondin historik dhe letrar të veprës së Emili Brontë	149
5.1 Emili Brontë dhe Epoka Viktoriane	149
5.1.1 Jeta e Emili Brontë dhe veprat e botuara	149
5.2 “Lartësitë e stuhishme”	155
5.2.1 Sfondi historik i romanit	155
5.3 Tipare të përgjithshme të romanit të Brontës	156
5.4 Tematikat në romanin “Lartësitë e stuhishme”	164
5.5 Trajtimi i problemeve të kohës.	165
5.5.1 Trajtimi i problemeve të ndryshme sociale në romanin e Emili Brontë	165
5.5.2 Elementët gjinorë në romanin “Lartësi të stuhishme”	172
5.5.3 Elementët feministë. Figura e gruas	173
5.5.4 Jeta e Ketrinës dhe Hithklifit dhe shtresat sociale	180
5.6 Elementet karakterizues	182
5.6.1 Simbolika	183
5.6.2 Stili i Emili Brontë në “Lartësitë e stuhishme”	184
5.6.3 Teknikat letrare të përdorura në romanin “Lartësitë e stuhishme”	185
5.7 Analiza rrëfimtare si akt ligjërimor	186
5.7.1 Struktura dhe interpretimi i rrëfimit në “Lartësitë e stuhishme”	188
5.7.2 Format e rrëfimit	189
5.7.2.1 Raportimi	189
5.7.2.2 Përshkrimi	190
5.7.2.3 Dialogu	190
5.7.2.4 Forma epistolare dhe forma gazetareske	191
5.7.3 Rrëfimtaret në romanin “Lartësitë e stuhishme”	193
5.7.3.1 Rrëfimtari Lokvud	193
5.7.3.2 Rrëfimtaria Neli Din	195
5.7.3.3 Kufizimet e Lokvudit dhe Neli Dinit si rrëfimtari	197
VI. Barasvlershmëria përkthimore dhe procesi i përkthimit në romanet	
“Tesi i d’Erbervilëve” dhe “Lartësitë e stuhishme”	201
6.1 Vështrim i shkurtër mbi Studimet Përkthimore, përkthimin dhe barasvlershmërinë përkthimore	201
6.2.1 Studimet Përkthimore në Shqipëri	203
6.2 Shembuj të vlerësimit dhe kritikës së përkthimit. Përcjellja e barasvlershmërisë	

funkionale të ligjërimit në gjuhën e përkthimit	206
6.2.1 Simbolika në romanin “Tesi i d’Erbervilëve”	206
6.2.1.1 <i>Simbolet dhe imazhet e lidhura me natyrën</i>	206
6.2.1.2 <i>Simbolet dhe imazhet e lidhura me kafshët</i>	208
6.2.1.3 <i>Simbolet dhe imazhet e lidhura me shpendët</i>	209
6.2.2 Dykuptimësia dhe interpretimi gjatë përkthimit të romanit në gjuhën shqipe	211
6.3 Dukuri përkthimore të modeleve feministe të teksteve tek “Tesi i d’Erbervilëve” dhe “Lartësitë e stuhishme”	216
6.3.1 Shembuj të vlerësimit të përcjelljes së barasvlershmërisë përkthimore dhe funksionale të diskriminimit gjinor në romanin “Tesi i d’Erbervilëve”	216
6.3.2 Analiza përkthimore në nvielin e ligjërimit në romanin “Tesi i d’Erbervilëve”	220
6.3.3 Shembuj të vlerësimit të përcjelljes së barasvlershmërisë përkthimore dhe funksionale të elementeve gjinore në romanin “Lartësite e stuhishme”. Figura e gruas	227
<i>Përfundime</i>	233
<i>Bibliografi</i>	241

HYRJE

Përligjja e temës

Në qendër të këtij studimi janë aspektet gjinore të përkthimit nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, e cila është bërë e njohur në botë si fushë studimore dhe kërkimore në Studimet Përkthimore, veçanërisht pas viteve '80 te shekullit XX dhe, në ditë e sotme, përbën një nga fushat me interes shumë të lartë studimi. Në Shqipëri studime të tilla janë të pakta, madje mund të themi se i kushtohet pak rëndësi.

Përzgjedhja e temës së këtij punimit të disertacionit nuk ka qenë një rastësi. Në studimet e mia për të marrë titullin Master i Shkencave, kam paraqitur punimin me titull "Aspekte të analizës dhe kritikës së përkthimit tek romani 'Tesi i d'Erbervilëve' i Tomas Hardit", punim në të cilin kam përfshirë përveç punës krahasimore, edhe analizën e shumë aspekteve letrare, gjuhësore e shoqërore. Në këtë fazë të mëvonshme, u nxitëm të bëjmë më tepër kërkime në aspektin teorik dhe praktik, të cilat përmblihen në këtë punim dhe menduam të zgjerojmë studimin tonë në të ardhmen duke studiuar dhe aspektet gjinore të tekstit, duke trajtuar përveç romanit "Tesi i d'Erbervilëve" edhe veprën e autores Viktoriane Emili Brontë "Lartësitë e stuhishme". Megjithatë, ky punim që rendit kontributet teorike të studiuesve të ndryshëm, nuk do të ishte i plotë pa u mbështetur në shembuj konkretë, të cilët përbëjnë një studim të mirëfilltë analitik dhe krahasues, prandaj, çdo çështje apo problematikë e trajtuar nga ana teorike është mbështetur nga shembuj konkretë. Studimi krahasues dhe vlerësues do t'i kushtojë rëndësi pikërisht aspekteve gjinore në procesin e përkthimit nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, duke arsyetuar se përse mendohet të konsiderohet si degë e veçantë në kuadrin e Studimeve Përkthimore krahasuese. Për këtë qëllim, në këtë punim disertacioni kemi përfshirë një serë shembujsh nga librat e përkthyer për të analizuar qëndrimin e mbajtur nga përkthyesit ndaj veprës origjinale duke hamendësuar mbi arsyet e tyre në përpjekje për të nxjerrë përfundime mbi strategjitë e përdorura gjatë përkthimit.

Në këtë studim analizohen, si nga ana teorike ashtu dhe nga ana praktike, aspektet gjinore, me qëllim zgjimin e interesit të studiuesve për këtë fushë kaq interesante, që paraqet edhe më shumë interes gjatë kalimit nga njëra gjuhë dhe/apo kulturë në tjetrën. Besojmë se ky punim do të shërbejë për të zgjeruar gamën e diskutimit, studimit dhe kërkimit shkencor, duke pasur parasysh natyrën gjithëpërfshirëse të tij. Ajo çka shpresojmë të arrijmë nëpërmjet këtij studimi, ndër të tjera, është informimi dhe rritja e interesit rreth studimit të kësaj fushe me natyrë gjinore dhe çeljes së shtigjeve të reja të studimit në të ardhmen, duke u munduar të rrisim ndihmesën në një fushë sa tërheqëse aq edhe delikate, sa të thjeshtë në pamje të parë, por aq edhe të ndërlikuar.

Objekti i studimit

Objekti kryesor i këtij studimi është të hedhë dritë e të sjellë informacion mbi një fushë pak të prekur në kuadrin e Studimeve Përkthimore në Shqipëri: aspektet gjinore në përkthimin nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Pjesa teorike zë një vend të konsiderueshëm të studimit, fillimisht duke ndërtuar një kuadër teorik rretë vetë studimeve gjinore e përkthimore. Aspekte të tjera teorike të përshkruara bazohen në shembuj konkretë, gjë që bën të mundur të kuptojmë edhe më mirë aspektet e përshkruara në secilin prej krerëve pjesë përbërëse të këtij punimi. Dukuritë e përshkruara teorikisht pasurohen edhe bëhen më konkrete nëpërmjet rasteve studimore. Ky studim do të trajtojë edhe një gamë të gjerë çështjesh të tjera problematike për përkthyesin në përgjithësi dhe për përkthyesin e kësaj letërsisë në veçanti, si për shembull, përkthimi i emrave të përveçëm, lojërave të fjalëve, dukurive kulturore e dialektore,

nënkuptimeve, ilustrimeve, etj. Shkalla e përcjelljes së tyre në gjuhën shqipe do të pasqyrohet nëpërmjet shembujsh e do të interpretohet edhe në mënyrë grafike. Gjithashtu, nëpërmjet shembujve konkretë synojmë të nxjerrim përfundime edhe mbi përzgjedhjen e fjalëve nga ana e përkthyesit kundrejt shkrimtarit të veprës origjinale, shkallën e përcjelljes së efektit të barasvlershëm, si dhe strategjitë e përdorura nga përkthyesi, nisur nga fakti se lexuesit e tekstit të përkthyer do të jenë grupime të ndryshme gjinore.

Nëpërmjet këtij punimi synojmë të analizojmë, si nga ana teorike ashtu dhe nga ana praktike, aspektet gjinore në përkthimin nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe do të argumentojmë trajtimin e aspekteve gjinore në përkthimin nga gjuha angleze në gjuhën shqipe si fushë e veçantë studimi në kuadrin e Studimeve Përkthimore. Çështjet dhe nënçështjet e ndryshme, së bashku me një material të gjerë shembujsh vjelë nga veprat më të njohura të këtij grupimi letrar, të shqyrtuara në plan krahasues, do t'u mundësojnë lexuesve të këtij punimi ta shohin këtë lloj letërsie nga një këndvështrim i ri, dhe për më tepër, përkthimin e kësaj letërsie si një instrument teorik dhe praktik në duart e përkthyesve në veçanti dhe lexuesve në përgjithësi.

Meqenëse ky punim është ndër hapat e para që hidhen në fushën e studimit të aspekteve gjinore në kuadër të Studimeve Përkthimore, gjatë hartimit të studimit dhe analizimit të dukurive dhe nxjerrjes së përfundimeve në bazë të analizave përkatëse, kemi pasur gjithmonë parasysh zgjimin e interesit të gjerë në lidhje me një fushë pak të studiuar në Shqipëri, duke synuar gjithashtu t'u vijmë në ndihmë përkthyesve të letërsisë për të rritur e për fëmijë, si për përkthimin e veprave të papërkthyer më parë, por njëkohësisht edhe për rishikimin e veprave të përkthyer tashmë. Nëpërmjet përfundimeve dhe rekomandimeve që do të sjellim në fund të këtij punimi krahasues, synojmë t'ju vijmë në ndihmë përkthyesve të në lidhje me aspektet gjinore të përkthimit letrar. Gjithashtu, punimi mund të gjejë zbatueshmëri edhe në lidhje me përkthimin në përgjithësi, meqenëse përfundimet në lidhje me një sërë strategjish të përdorura që do t'i nxjerrim në pah nëpërmjet shembujve konkretë dhe nëpërmjet krahasimit të vazhdueshëm me origjinalin dhe me variantet e përkthyer dhe shkallën e përdorimit të tyre mund të shfrytëzohen gjerësisht nga përkthyesit në punën e tyre, pa u kufizuar thjesht nga lloji i gjinisë së përkthyer.

Fusha e përkthimit dhe aspekteve gjinore të përkthimeve nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, edhe pse e spikatur vetëm gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve të fundit, paraqet interes në shkallë ndërkombëtare, prandaj edhe studimet teorike e praktike në këtë fushë kërkimore-shkencore po zënë një vend gjithnjë e më domethënës brenda Studimeve Përkthimore. Për t'i dhënë këtij studimi një bazë të nevojshme teorike kemi shfletuar dhe studiuar një sërë shkrimesh, titujt dhe autorët e së cilëve do t'i përmendim më poshtë. Nga ana tjetër, për të sjellë një punim sa më gjithëpërfshirës që do të na çojë edhe drejt përfundimeve më konkrete në këtë fushë të përkthimit letrar, ne do të shfrytëzojmë një sërë librash që konsiderohen klasike në letërsinë me në qendër figurën e gruas dhe do të përpiqemi të gjejmë variantet e përkthyer në shqip ndër vite. Një pjesë të mirë të të dhënave që do të nxjerrim nga shembujt e vjelë do të organizohen në mënyrë tematike për lehtësi praktike dhe orientim të shpejtë, që do të na çojë drejt përfundimeve të zbatueshme në fushën që kemi përzgjedhur.

Metodologjia dhe struktura e punimit

Ky studim është ndërtuar mbi bazën e hulumtimeve të materialeve të ndryshme të fushës së Studimeve Përkthimore dhe të stilistikës feministe. Kemi shfletuar një sërë librash të botuara, studime e artikuj me natyrë analitike dhe krahasimore. Të gjitha këto materiale kanë shërbyer në hartimin e pjesës teorike të punimit tonë si dhe për të organizuar pjesën praktike, të cilën e kemi pasuruar me shembuj konkretë nga korpusi që kemi përzgjedhur për t'u shqyrtuar në këtë

punim. Për të zhvilluar pjesën praktike, kemi kryer një analizë të hollësishme letrare, përkthimore e krahasimore të veprave origjinale me variantin e gjuhës shqipe.

Punimi me titull "Aspekte teorike dhe praktike të dukurive përkthimore dhe gjinore në përkthimet nga gjuha angleze në gjuhën shqipe", të cilin nga pikëpamja strukturore e kemi konceptuar të ndarë në gjashtë krerë, përqendrohet në trajtimin e dukurive gjinore të strukturimit të veprave letrare me në qendër figurën e femrës, në analizën e tekstit dhe funksionimin e tij brenda sistemit. Po ashtu, trajton elementët karakterizues të krijimtarisë së Tomas Hardit e të Emili Brontës, të akteve ligjërimore, në analizimin e simboleve, imazheve, të aspekteve të interpretimit, rrëfimit dhe aspekteve gjinore në romanet "Tesi i d'Erbervilëve" dhe "Lartësi të stuhishme" si dhe analizën përkthimore në bazë të përkthimit të përkthyesve përkatës, Bujar Doko dhe Amik Kasoraho.

Në Kreun e Parë do të përshkruhet një formë e analizës feministe, e cila i kushton rëndësi të veçantë aspektit gjinor. Kjo analizë merret, jo vetëm me identifikimin e seksizmit në një tekst të caktuar, por edhe me lidhjen e ngushtë që ka midis veprimeve, pikëpamjeve, metaforave e elementëve të tjerë me çështjet e përkatësisë gjinore. Në këtë kre, ne synojmë që nëpërmjet një leximi të hollësishëm dhe përdorimit të teknikave të ndryshme gjuhësore e letrare, t'i paraqesim lexuesit një gamë të gjerë fjalësh, të cilat tregojnë se çfarë ndodh në tekste dhe çfarë ndodh me lexuesin gjatë procesit të leximit. Po ashtu, në këtë kre trajtohen modelet e ndryshme të teksteve që i nënshtrohen analizës feministe. Do të bëhen analiza të tekstit duke u siguruar fillimisht mbi modelin që do të përdorim, pasi kjo ndërlikon mënyrën e analizës dhe interpretimit, duke shqyrtuar në fillim tekstet dhe lidhjen e tyre me kontekstin dhe lexuesin, aty ky vihen në zbatim teoritë gjinore.

Në Kreun e Dytë do të përqendrohemi në analizën e tekstit dhe funksionimit të tij brenda sistemit, duke trajtuar fillimisht aspektet gjinore në nivelin e fjalës, në aspektet e përgjithshme e teorike të seksizmit, në format e ndryshme të përdorimit të gjuhës seksiste, si dhe në mënyrën se si kritika feministe e trajton seksizmin në gjuhë dhe ndikimin që ka përdorimi i kësaj gjuhe tek lexuesit, veçanërisht tek lexueset femra. Në këtë kre do të shohim se pavarësisht faktit që mund të nxitemi nga rregullat e gjuhës për të folur në një mënyrë të caktuar, për të përforcuar disa vizione mbi potencialin e femrave dhe meshkujve në shoqëri, ekzistojnë shumë opsione në dispozicion të folësve për të shmangur seksizmin në gjuhë. Ne do të sjellim shembuj të përdorimit të gjuhës pa nuanca seksiste, si dhe disa strategji për të neutralizuar paragjykimet gjinore në përgjithësi. Po ashtu, do të studiojmë përdorimin e gjuhës përtej nivelit të fjalës, pra në nivelin e frazës apo të fjalisë, duke analizuar mënyrën se si shprehjet, frazat dhe fjalitë lidhen me elementët e tjerë gjuhësorë, me kontekstin, historinë e përdorimit të tyre. Në këtë kre, do të shqyrtojmë si feministët mund të kryejnë një analizë gjinore duke u bazuar në një nivel tjetër, në nivelin e ligjërimit, duke mos u përqendruar tek përmbajtja si të ishte e vetëkuptueshme, por të shohim thelbin e tekstit si kalimin e elementëve tekstualë dhe kodeve jashtë tekstit, të cilët ndikojnë, si në mënyrën e ndërtimit të tekstit, ashtu edhe në mënyrën që ne deshifrojmë atë që është shkruar. Këtu do të diskutojmë kryesisht krijimin e personazhit në tekste, do të analizojmë mënyrën se si nocionet stereotipike shpesh informojnë zgjedhjet gjuhësore që bëhen kur përshkruajmë personazhet në letërsi artistike dhe në gazeta, si dhe mënyrën si njerëzit përshkruajnë veten.

Në Kreun e Tretë do të japim një vështrim të përgjithshëm të epokës Viktoriane dhe të jetëshkrimit të shkrimtarit gjatë kësaj epoke, faktorët historikë dhe sfondin historiko-letrar, të cilët përcaktuan krijimtarinë letrare të Tomas Hardit, veprat e botuara dhe karakteristikat e veprave të tij. Në kuadrin e shqyrtimit të romanit "Tesi i d'Erbervilëve" do të përshkruajmë mënyrën se si ai trajton problemet e kohës, siç janë puna e rëndë e fshatarëve, martesat munduese, çështja e gruas, jeta e zyrtë e grave të shtypura si pasojë e konvencionalizmave shoqërore, mohimi i forcës politike dhe ekonomike të gruas, çështja e divorcit etj. Po ashtu, në këtë pjesë të disertacionit do të trajtohen aktet ligjërimore, ku do të analizojmë veprimet në përgjithësi, të natyrës verbale dhe fizike, por në mënyrë të veçantë ato të funksionit të gjuhës si diçka më tepër së një mjet njohjeje.

Në vijim të këtij kreu do të përqendrohemi në analizën e rrëfimit si akt ligjërimor, për të treguar që teoria e ligjëritimit, është thelbësore për të kuptuar Hardin.

Në Kreun e Katërt do të analizojmë simbolet e huazuara nga natyra, nga kafshët, shpendët, gjaku, peizazhi, e i pothuajse çdo detaji që jepet rreth botës së natyrës, të cilët tek “Tesi i d’Erbervilëve”, thellojnë depërtimin psikologjik të lexuesit tek Tesi, si dhe pasqyron bukurinë tragjike të jetës së saj. Po ashtu, do të shqyrtojmë natyrën dhe ndikimin e pranisë së Hardit në këtë roman, e cila ka si synim kanalizimin e reagimit të lexuesve ndaj personazheve dhe ngjarjeve. Për të arritur këtë Hardi përdor përshkrimet e sheshta dhe tonin indinjues, madje revoltues. Gjithashtu, do të analizojmë se si ndikon prania e autorit gjatë ndërprerjeve të rrëfimit, siç është fillimi apo fundi i fazave. Në këtë kre do të trajtojmë edhe çështjen e dykuptimësisë dhe interpretimit të rrëfimit tek “Tesi i d’Erbervilëve”. Leximi i romaneve të Tomas Hardit, për vetë natyrën sfiduese dhe nxitëse të rrëfimit, krijon tek lexuesit, ndjesinë e një veprimtarie krijuese dhe të këndshme, në bazë të së cilës është zhvillimi i mëtejshëm i aftësive dhe shprehive të të menduarit analitik dhe kritik.

Në Kreun e Pestë të këtij punimi do të sjellim një vështrim panoramik mbi sfondin historik dhe letrar të veprës së Emili Brontë në kuadrin e epokës Viktoriane, jetëshkrimet të saj, faktorët historikë dhe shoqëror që ndikuan në krijimtarinë e saj. Në shqyrtimin e romanit “Lartësitë e stuhishme”, romani i vetëm i shkrimtares Viktoriane, do të flasim rreth tipareve të përgjithshme të romanit, tematikave të ndryshme, problemeve të kohës, do të diskutojmë për elementet gjinore dhe feministe, për figurën e gruas, për jetën e Ketrinës dhe Hithklifit në shoqërinë Viktoriane, etj. Po ashtu, do të analizojmë simbolikën në roman, stilin e autores, teknikat letrare të përdorura, si dhe rrëfimin si akt ligjërimor dhe format rrëfimtare.

Në një vështrim të shkurtër mbi Studimet Përkthimore në gjuhën angleze dhe shqipe, në Kreun e Gjashtë, duke pasur parasysh se problemet e përkthimit shfaqen gjatë zbatimit në praktikë të kërkesave dhe parimeve të metodave përkatëse, gjatë zbatimit të përftesave përkthimore, do të shqyrtojmë mënyrën se si ndërthuret praktika përkthimore me punën e studiuesve të përkthimit. Duke iu referuar veprave të teoricienëve të huaj të përkthimit, si dhe punimeve të mëparshme në fushën e Studimeve Përkthimore në Shqipëri, do të vërejmë se si trajtimi i procesit të përkthimit, si dhe kritikës përkthimore në kuadrin e teorisë së përkthimit, nuk presupozon paraqitjen dhe imponimin e vetëm një mënyre përkthimi, por sugjerimin e alternativave të shumëllojshme, në mënyrë që përkthyesi të ketë mundësi zgjedhjeje. Në këtë kre, në kuadrin e Studimeve Përkthimore, të cilët kanë natyrë aplikative, shumëdisiplinore, në zhvillim të përhershëm, do të përqendrohemi në mënyrat e përcjelljes së barasvlershmërisë funksionale të tipareve idiolektike në procesin e përkthimit të letërsisë artistike si dhe, në një fare mase, edhe në vlerësimin e përkthimit të veprës letrare në kuadrin e Studimeve Përkthimore. Kështu që në këtë pjesë të disertacionit, vëmendja kryesisht do të përqendrohet tek krijimi i efekteve të barasvlershme, ose të ngjashme me origjinalin, duke nxjerrë në pah mënyrën se si përkthyesi, ashtu siç sugjerojnë studiuesit, strukturon në gjuhën e përkthimit një tekst në të cilin ndërthuren saktësia semantike me funksionalitetin pragmatik të kontekstit të ri gjuhësor dhe kulturor, në përshtatje me kushtet e komunikimit dhe situatën ligjërimore.

Në këtë kre, krahas shembujve të shumtë të analizuar dhe komentuar gjatë shqyrtimit të mënyrës se si Tomas Hardi dhe Emili Brontë kanë shfrytëzuar mjetet gjuhësore dhe stilistike për individualizimin dhe karakterizimin e personazheve kryesorë në romanet “Tesi i d’Erbervilëve” dhe “Lartësi të stuhishme”, vëmendje të veçantë do t’i kushtojmë mënyrës se si përkthyesit Bujar Doko dhe Amik Kasoruhë kanë manipuluar përftesat përkthimore gjatë përcjelljes së këtyre veprave letrare në gjuhën shqipe, si dhe kanë mundur të realizojnë kalimin e strukturave të barasvlershme nga njëra gjuhë në tjetrën, në përputhje me normat e gjuhës së përkthimit. Për vetë rëndësinë që kanë transpozimi, si dhe ekuivalenca apo barasvlershmëria gjuhësore dhe kulturore, do të përqendrohemi kryesisht tek këto përftesa, si dhe në mënyrën se si në shumicën e rasteve ato ndërveprojnë dhe ndërthuren me përftesa përkthimore jo më pak të rëndësishme si

natyrshmëria, analiza komponenciale, përkthimi antonimik, sinonimia kontekstuale, konkretizimi dhe kontekstualizimi i përkthimit, përftesat grafike, etj.

PERFUNDIME

Punimin me titull "Aspekte teorike dhe praktike të dukurive përkthimore dhe gjinore në përkthimet nga gjuha angleze në gjuhën shqipe", me objekt trajtimin e dukurive gjinore të strukturimit të veprave letrare, analizën e tekstit dhe funksionimin e tij brenda sistemit, si dhe analizën teorike e praktike të aspekteve gjinore në përkthimin nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, e filluam me përshkrimin e një forme të analizës feministe, së cilës gjatë punimit i jemi referuar si "stilistikë feministe", e cila synon të hedhë dritë mbi disa hipoteza që qëndrojnë në themel të stilistikës tradicionale, duke shtuar ndër të tjera edhe aspektin gjinor në listën e elementeve që ngjallin interes për t'u analizuar, duke e çuar stilistikën drejt një faze të re. Stilistika feministe ka gjithashtu për qëllim të tregojë se aspekti gjinor del në pah në momente kyçe dhe shpesh merret në shqyrtim në forma të njohura për ne. Shpesh këto momente na duken të zakonshme, por nxjerrja në pah e tyre na bën t'i lexojmë ndryshe. Stilistika feministe është një zhvendosje nga kritika e brendësisë së tekstit drejt një studimi teorik të atyre faktorëve jashtë tekstualë të cilët mund të përcaktojnë ose ndërveprojnë me elementë brenda tekstit, prandaj termi 'kontekst' duhet rishikuar, pasi edhe pse gjinia mund të merret si një element jashtë-tekstual, ajo mund të shihet si pjesë e tekstit, si një 'gjurmëlënëse' brenda tekstit, ashtu sikurse në mënyrë të pashmangshme të gjurmë çdo kufizim ose përcaktim tjetër. Supozimi se konteksti i krijimit të tekstit do të lërë gjurmë në interpretimin e tij dhe se duhet të jetë me rëndësi për kritikun mund të tingëllojë si një ri-zbulim i çështjes së kontekstit socio-historik në kritikën tradicionale letrare. Megjithatë, ne duam të paraqesim një rast ku konteksti trajtohet në një formë më teorike në kuadrin e trajtimit të analizës së teksteve letrare. Një theksim i njëjësive leksikore dhe mënyrës si bashkëveprojnë me kontekstin mund të ndihmojë lexuesin të mënjanonjë disa prej raporteve të përgjithësuara shkak-pasojë, të cilët janë parashtruar nga kritikët tradicionalë të stilistikës dhe mund të përfshijë edhe aspektin gjinor gjatë kryerjes së kritikës. Përsa u përket modeleve feministe të teksteve, mund të themi se ato shmangin disa prej problematikave dhe e zgjeron më tej përkufizimin tonë për kontekstin, përkatësisht konteksti gjatë krijimit të tekstit dhe konteksti që lidhet me pritjen e tekstit.

Gjini të ndryshme përdorin fjali të ndryshme? Sipas feministëve francezë, mënyra si shkruajnë femrat është krejtësisht e ndryshme nga mënyra se si shkruajnë meshkujt përsa i përket strukturës gjuhësore dhe përmbajtjes, por me përjashtim të V. Woolf asnjëra nuk jep një përkufizim për fjalinë mashkullore, kjo për arsye se e marrin të mirëqenë si një kategori normale e zakonshme dhe e njohur nga të gjithë. Ato shprehen se shkrimtarët meshkuj mund ta përdorin fjalinë femërore kur shkrimet e tyre arrijnë një formë biseksualiteti ose androgjinie. Ato nuk japin udhëzime për femrat mund të përdorin fjalinë mashkullore edhe kur mund ta bëjnë diçka të tillë. Si përfundim, ato nuk e bëjnë të qartë nëse kjo fjali është rezultat i një procesi të pandërgjegjshëm që zbatohet nga të gjitha femrat, ose nëse është një përdorim i ndërgjegjshëm artistik. Brenda një tradite të përgjithshme, shkrimtaret femra kanë një shumëllojshmëri variantesh kur shkruajnë për të krijuar tekstet e tyre. Ato mund të imitojnë stilet mashkullore të të shkruarit ose dhe ato femërore, ose të vendosin t'i kundërshtojnë këto tradita duke i përdorur dhe dëmtuar me vetëdije, duke iu drejtuar një lexuesi femëror. Elementet ose të dhënat e një teksti mund të përdoren për të diferencuar stilet nga njëri-tjetri. Për shembull, stili sintaksor që është imitimi i stilit formal të dokumenteve zyrtare, stili ligjor ose letërsia kanonike, mund të sinjalizojë lexuesin se shkrimtari i përket një tradite mashkullore. Proza, ku strukturat sintaksore janë më afër formave të ligjërit bisedor, ose përdor regjistra të ndryshëm

për të shkatërruar atë formal, e kundërshton traditën dhe si rrjedhim sugjeron një përkatësi ndaj traditës femërore.

Leksiku i përdorur është një e dhënë tjetër që përcakton përkatësinë e tekstit. Termat dhe fjalët që lidhen me stereotipat gjinorë mund të përdoren me vetëdije, por nuk mund të interpretohen të marra veçmas nga konteksti, duke qenë se mund të përdoren me ironi, ose tu atribuohen personazheve si cilësi pozitive ose negative. Megjithatë, në tekst ka disa momente ku përkatësia e autorit duket shumë qartë. Përmbajtja e tekstit gjithashtu përmban të dhëna, për shembull, një personazh kryesor femër dhe përqendrimi në marrëdhëniet e saj me personazhet e tjera femra është një tipar që mund të tregojë një përkatësi femërore të tekstit. Nocioni i përkatësisë femërore do të thotë që nuk është e nevojshme që thjesht të kategorizohet shkrimi si i shkruar nga një autor femër ose mashkull dhe të mendohet se ka ndryshime stilistike në tekst për shkak të atij dallimi biologjik.

Në kreun e dytë, ku u morëm me analizën e tekstit dhe funksionimin e tij brenda sistemit, trajtuam aspektet gjinore në nivelin e fjalës, seksizmin dhe format e ndryshme të përdorimit të gjuhës seksiste, si dhe me mënyrën si kritika feministe trajton seksizmin në gjuhë dhe ndikimin e tij tek lexuesi. Këtu analizuam shembuj të ndryshëm të marrë nga fjalorët, përemrat e pacaktuar, emrat e përgjithshëm, shembuj të diskriminimit gjinor dhe androcentrizmit, eufemizmat, etj. dhe, kur flasim për kuptimin, ekziston një çështje së cilës duhet t'i kthehemi në mënyrë të pashmangshme. Kjo ka të bëjë me faktin nëse gjuha angleze është ose jo një gjuhë seksiste, e cila prodhon një shoqëri seksiste, me një linjë mendimesh androcentrike, ose nëse shoqëria është në themel seksiste diku jashtë gjuhës, ndërsa gjuha thjesht reflekton seksizmin e sistemit. Nëse do të mund të reformonim gjuhën, do të mund të ishim të aftë të eliminonim seksizmin. Nga ana tjetër, reformimi i gjuhës nuk do t'i shërbente askujt, pasi fjalët e reja do të infektoheshin me kuptimet e vjetra menjëherë sapo të hynin në përdorim. Shembujt e prishjes semantike që përmendëm në këtë kre, ku fjalët të cilat janë të lidhura me femrën bien nga statusi automatikisht, tregojnë se reformimi i gjuhës nuk mund të arrihet për sa kohë që shoqëria në tërësi qëndron seksiste.

Megjithatë theksohet se burimet semantike në dispozicion ndaj folësve janë pjesë e sistemit që prodhon seksizmin, të menduarit rreth kuptimit dhe ndërgjegjësimi i të tjerëve për nënkuptimet e përdorimit të tyre gjuhësore janë rrugë për zvogëlimin e krijimit të vazhdueshëm të kuptimeve seksiste. Kuptimet nuk janë të përjetshëm në fjalorë, gjuha i përgjigjet kërkesave të reja të cilat parashtrihen nga folësit e saj. Ndërgjegjësimi në rritje ka sjellë ndryshime të institucionalizuara në përdorimin e gjuhës, shumë terma seksistë dhe racistë nuk shfaqen më, ose shfaqen më rrallë. Edhe nëse ndryshimet në përdorim nuk arrijnë një ndryshim total në sjellje, njerëzit janë të detyruar të përballen me sjelljet e tyre kur të përdoren këto terma. Përsa i përket analizës stilistike në nivelin e frazës/fjalisë dhe në nivelin e ligjërimit, analizuam shprehjet e gatshme, metaforat, foljet kalimtare dhe jokalmimtare, teknikën e fragmentimit, fokalizimin.

Stilistika Feministe na tregon mënyra sipas të cilave ata që merren me paraqitjen e lidhjeve gjinore mund të mbështeten në analizën gjuhësore për të zhvilluar një grup mjetesh që mund të ekspozojnë funksionimet e gjinisë në nivele të ndryshme në tekste. Për shkak të natyrës së analizës feministe, ka qenë e nevojshme vënia në dyshim e kufijve në dukje të vetëkuptueshëm të vetë tekstit, duke argumentuar se ai është i përshkruar nga ligjërata dhe ideologji dhe se dallimi tekstual dhe jashtë-tekstual nuk mund të pranohet. Tekstet janë të dyndur nga normat sociokulturore, nga ideologjitë, nga historia, nga forcat ekonomike, nga stilet, nga gjinitë dhe paragjykimet raciale, e kështu me radhë. Kjo nuk do të thotë se autorët nuk kanë asnjë lloj kontrolli për atë çka shkruajnë, por se edhe ata vetë janë të varur nga ndërveprimi me këto forca të "marra". Ky mund të jetë një shkak për pesimizëm, pasi nëse tekstet janë vendet e përcaktimit ideologjik, atëherë ne nuk mund të bëjmë gjë tjetër, veçse t'i nënshtrohemi sulmit të ideologjisë. Megjithatë, nëse marrim modelin e lidhjeve të fuqisë nga M.

Foucault është mjaft e qartë se 'ku ka pushtet, ka rezistencë'. Prandaj pushteti nënkupton nocionin e rezistencës. Autorët dhe lexuesit nuk janë pasivë, por mund të marrin një rol në negociim, duke ripërcaktuar kështu qëllimin dhe natyrën e këtyre strukturave më të mëdha e të koklavitura.

Është e nevojshme të analizohen një numër i madh faktorësh, si roli i lexuesit dhe suazat e gjinizuara. Ky fokus në strukturat makro dhe mikro do të bënte të mundur një analizë më të detajuar, një analizë që është ndoshta më pak efikase se analiza e thjeshtë leksikore që parapëlqehet nga stilistikat formaliste. Megjithatë, në këtë mënyrë është e mundur të merret parasysh marrëdhënia midis pjesëve leksikore dhe suazave të ligjëratës. Është e qartë se marrëdhënia nuk është diçka që mund të përcaktohet lehtë, pjesët leksikore janë të përcaktuara nga suazat ligjërimore. Ekziston një nivel i caktuar bashkëveprimi dhe diskutimi, thjesht sepse këto pjesë leksikore janë përdorur dhe përjetuar nga individët, të cilët përmes përdorimit të tyre dhe analizës së termave sjellin ndryshime në strukturat më të mëdha. Analiza që mbështetet në këtë model ligjërator dhe praktike detyrimisht do të interesohet për ndryshimin e strukturave dhe mënyrave të të menduarit. Përpyekjet dhe punimet feministe kanë sjellë ndryshime në praktikat paraqitëse përmes kritikës, përmes mësimdhënies dhe zhvillimit të modeleve të reja të praktikës së të shkruarit.

Në kreun e tretë kemi hedhur një vështrim të përgjithshëm të epokës Viktoriane, epokë gjatë së cilës ka jetuar dhe shkrimtari Tomas Hardi. Kushtet ekonomike dhe shoqërore të kësaj periudhe ishin më të vështira se kurrë, sidomos për popullsinë fshatare. Kjo epokë solli vepra të mrekullueshme letrare. Shkrimtari i shquar Tomas Hardi krijoi vepra që prekën jo vetëm zemrat e lexuesve të asaj kohe, por edhe të lexuesve të sotëm. Veprat e tij pasqyrojnë jetën e njerëzve gjatë epokës Viktoriane. Hardi dhe shkrimtarë të tjerë si ai shkruanin në këtë formë për të ndryshuar, mbështetur, zgjeruar, për të lehtësuar e për t'u ballafaquar me kulturën dhe ndjenjat e popullit. Po ashtu, Hardi kritikon rolin negativ të Revolucionit Industrial gjatë epokës Viktoriane. Ai shkruan për rëndësinë e gruas në blegtori, për punën e rëndë të fshatarëve, si dhe për mënyrën se si ndikojnë vendimet e gabuara të prindërve në jetën e fëmijëve, për zhgënjimin në dashuri dhe në jetë, për jetën e zymtë të grave të shtypura, për martesën e mundimshme dhe jo të lumtura, si dhe për luftën e gjatë të njerëzimit kundër indiferencës ndaj vuajtjeve njerëzore. Personazhet e tij luftojnë për një betejë të humbur në një univers të pakuptimtë. Romanet e Hardit përcjellin një ndjenjë të fortë fatalizmi, ku veprimet e njerëzve janë të parapërcaktuara në jetë, nga vetë natyra e rrethanave, nga Zoti ose nga fati. Në veprat e tij, jo vetëm forcat e natyrës, por edhe shoqëria njerëzore duket sikur priret të shtypë individin. Shoqëria, me anë të konvencionalizmave të vjetruara dhe vlerave sipërfaqësore i sjell atij vuajtje.

Përsa i përket vendit të Hardit dhe arritjeve të tij në letërsinë Viktoriane, mund të themi se është një nga shkrimtarët, veprat e të cilit janë përfolur dhe gjykuar ashpër nga kritikët e epokës Viktoriane. Ata e përshkruanin Hardin si një anakronist, përkundrazi ai është një nga shkrimtarët më të mirë Viktorianë, i cili ka arritur të paraqesë me vërtetësi realitetin tek lexuesit e tij. Ai shumë haptazi trajton çështjet e ekstremizmit shoqëror. Lexuesit e asaj periudhe e toleronin trajtimin që i bënte Hardi problemeve të karakterit modern, por ishin më pak të hapur ndaj skepticizmit të tij fetar dhe kritikave ndaj ligjeve për divorcin. Ato fragmente, të cilët sollën kaq shumë zemërim për lexuesin e periudhës së vonë Viktoriane, për lexuesin e shekullit XX, zemërimi dhe fyerja priren të humbasin, pasi Hardi i trajton këto çështje delikate me shumë saktësi. I frymëzuar nga çështjet e ngatërruara gjinore dhe klasore, në veçanti nga rëndësia e arsimit dhe martesës, si burime që sigurojnë rritje të nivelit shoqëror, Hardi e portretizon në mënyrë tepër të zgjuar dhe të dhimbsur gruan. Edhe pse përpyekjet e tij të para për të sulmuar qëndrimin Viktorian u penguan nga censura, romancieri vazhdoi të përkrahë betejën e gruas së fortë, të zgjuar dhe joshëse për të arritur pavarësinë dhe lirinë sociale.

Në kreun e tretë të punimit tonë, gjithashtu analizuam dhe tiparet e romaneve të Hardit. Në përgjithësi ngjarjet zhvillohen në zonat rurale të Ueseksit. Ato trajtojnë jetën e fermerëve në qytezën e Dorsetit dhe shfaqet keqardhje për këtë shtresë të popullsisë. Nga ana topografike Hardi është tepër specifik, tipar i pashembullt në letërsinë angleze. Ai nuk shmang artificialitetin

sa herë që përfshihet “shoqëria e edukuar”. Shpesh herë dialogu është joreal dhe shpesh herë vëmë re një ngurtësi tek gjuha e përdorur, fjali të ngatërruara, ndryshime të çuditshme të rendit të fjalëve në fjali, forma të ndara të paskajores, etj. Në kontradiktë me këto të meta retorike, gjejmë një aftësi të spikatur shprehëse, sidomos në fragmentet përshkruese, po ashtu vërejmë dhe një ndjeshmëri të zhvilluar të autorit. Natyra zë vend të rëndësishëm në krijimtarinë e tij dhe trajtimi që i bëhet asaj është tepër poetik. Gjejmë citime dhe shprehje filozofike e letrare, përmenden shpesh piktorë, muzikantë dhe arkitektë. Kemi tejpërdorim të rastësisë, bashkimin e të dashuruarve në një martesë sekrete. Në romanet e tij, sundon shpesh një atmosferë e zymtë, e cila menjëherë gjallërohet. Të gjithë kanë fund tragjik.

Në kuadër të analizës gjuhësore e letrare të romanit “Tesi i d’Erbervilëve”, pasi shqyrtoam simbolet dhe imazhet”, dalim në përfundimin se shumica e tyre janë të huazuara nga natyra. Përshkrimet e peizazhit nga ana e autorit na ndihmojnë për të kuptuar Tesin dhe imazhet e tjera për të kuptuar dhe interpretuar veprimet e saj. Ndërsa për të qartësuar karakterin e heroinës, na jepet një gamë e gjerë krahasimesh dhe metaforash për te nxjerrë në pah unitetin e saj me natyrën, kryesisht me të bukurën. Po ashtu, vëmë re që imazhet e kafshëve janë të shpeshta në përshkrimin e Tesit. Ajo identifikohet me kafshët shtëpiake, kryesisht me macen dhe me leopardin. Po ashtu, Hardi përdor disa imazhe të huazuara nga shpendët, të cilët shërbejnë për të nxjerrë në pah hijeshinë dhe bukurinë e Tesit. Simbol tjetër i fuqishëm është edhe ai i gjakut. Pasi analizuam të gjithë imazhet që Hardi përdor për të nxjerrë në pah karakterin dhe gjendjen e Tesit, kaluam në një çështje tjetër, atë të funksionit simbolik të peizazhit. Në romanet e Hardit, veçanërisht tek “Tesi i d’Erbervilëve”, mjedisi rrethues fizik është tepër i rëndësishëm për të kuptuar personazhet e tij dhe jetën e tyre shpirtërore. Ajo që ngjalli më shumë interes për ne ishte aftësia pasqyruese e natyrës. Ndër detajet e paraqitura nga Hardi rreth pamjes së jashtme të Tesit janë edhe përshkrimet rreth veshjes së saj.

Gjithashtu, pasi analizuam dhe krahasuam personazhet nga romanet e tjerë të Hardit, ndjejmë se Tesi është figura që ne e njohim më mirë. Pikërisht fati i saj na prek më tepër dhe sigurisht ka një sërë arsyesh për këtë. Në një farë mënyre, tragjedia e Tesit pasqyron më së miri ashpërinë e rregullave dhe ligjit social, si dhe paragjykimin e një shoqërie patriarkale. Siç edhe theksuam më lart, përshkrimi i peizazhit natyror ndihmon në njohjen e Tesit. Çdo vend, ku Hardi e ka çuar personazhin e saj kryesor, është përshkruar me gjuhë të fuqishme dhe ndjellëse, gjë që na ndihmon të përjetojmë si nga afër jetën dhe fatin e saj të trishtë. Tek “Tesi i d’Erbervilëve”, përshkrimi i shpendëve, bimëve dhe i peizazhit në përgjithësi, më mirë të themi, i pothuajse çdo detaji që jepet rreth botës së natyrës, thëllon depërtimin psikologjik të lexuesit tek Tesi, si dhe pasqyron bukurinë tragjike të jetës së saj. Në kuadër të trajtimit të funksionit të pranisë së Hardit tek “Tesi i d’Erbervilëve”, mund të themi se ai përdoret për të kanalizuar reagimin e lexuesve ndaj personazheve dhe ngjarjeve. Tek “Tesi i d’Erbervilëve” përshkrimet e Hardit janë shumë më të shpeshta se në romanet e tjerë të tij. Po ashtu, edhe toni i përdorur ndryshon nga romanet e mëparshëm. Shpeshësia dhe toni i përshkrimeve të tij përcjellin tek lexuesi bindjen e sinqeritetin e autorit, si dhe rëndësinë e qëllimit të tij. Gjatë gjithë romanit, Hardi e përdor praninë e tij për të përgjithësuar përvojën e Tesit, për të treguar se fatkeqësitë e saj përfaqësojnë vuajtjet, të cilat në të shumtën e rasteve shoqërojnë njeriun. Hidhërimi në tonin e Hardit, po aq sa përmbajta e përshkrimeve të tij, flasin për karakterin shkatërrimtar të jetës, përfaqësuar nga fatkeqësitë e Tesit. Nëpërmjet komenteve, vëzhgimeve dhe dëshmimeve të tjera të pranisë së tij, lexuesi kupton dhe personalitetin e Hardit. Me anë të këtij romani, ai na shfaqet nëpërmjet zotërimit të njohurive të shumta filozofike. Kritikët dhe lexuesit shpesh kanë vënë re se stili i rrëfimit tek “Tesi i d’Erbervilëve” na pengon të kuptojmë historinë e saj, për shkak të disa fragmenteve jo të qartë dhe bindës. Në përgjithësi, kritikët bashkëkohorë mungesën e qartësisë së romanit, ia atribuojnë jo paaftësisë së Hardit për të sqaruar kuptimin, por indiferencës së tij për të pasur një lidhje logjike të argumenteve, të filozofisë apo ideologjisë të parashtruar gjatë rrëfimit. Mendohet se Hardi qëllimisht nuk jep një lidhje apo shpjegim logjik e

koherent të komenteve të tij gjatë rrëfimit, në mënyrë që të shmangë një interpretim të njëjtë nga ana e lexuesve. Po ashtu, Hardi jo vetëm që shmang një portretizim të qartë të karakterit të Tesit dhe një rrëfim të qëndrueshëm të ngjarjeve, por bën edhe aludime të pakuptimta, si dhe citon ide filozofike kontradiktore. Duke vepruar në këtë mënyrë, ai u ofron pamje të ndryshme, të shumëllojshme dhe kontradiktore”. Rrjedhimisht, lexuesi detyrohet të kuptojë realitetin në mënyrë subjektive, si të ndryshueshëm dhe nën efektin e filtrave të përshtypjeve të shumta dhe kontradiktore.

